



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.16/2018

Prishtinë, më 26 mars 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj Halimaj.

Munguan: Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi dhe Saranda Bogujevci.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Teuta Prekazi-UNHR, Nebih Maxhuni-RTK, Mehmet Krasniqi-Ekonomia Online, Maja Markovic-U.S.Embassy, Adem Gashi-USEP, Sanije Berisha-OSBE, Qendresa Mustafa-Birn, Visar Bovolaku-EVO/EUSR dhe Behxhet Shala.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L- 031  
për Lirinë Fetare në Kosovë
3. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtura më 9 mars 2018, u miratuan pa vërejtje.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L- 031 për Lirinë Fetare në Kosovë**

**Kryetarja** tha se për shqyrtimin e këtij projektligji komisioni ka formuar grupin punues i cili ka sjellë propozim amendamentet në komision të cilat do t'i shqyrtojmë në këtë mbledhje, tha se ndihet keq që në këtë mbledhje po mungon deputetja nga Lista Serbe, sepse ky subjekt ka propozuar 14 amendamente dhe shumicën prej tyre i kemi pranuar apo inkorporuar në riformulimet që janë bërë gjatë shqyrtimit të projektligjit.

Ndërsa sa i përket amendamentit që në nenin 11B, të shtohet një paragraf i ri nr.6 me këtë përmbajtje: **6. „Zëvendësdrejtori i Zyrës do të jetë përfaqësuesi i komunitetit serb të Kosovës.“**, grupi punues ka konstatuar se ky amendament nuk mund të pranohet për arsye se legjislacioni i Kosovës nuk e njeh një pozitë të tillë dhe është në kundërshtimi me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, por çdo pjesëtar i cilës do përkatësie etnike, kanë mundësi të konkurrimit edhe për pozitën e drejtorit, mundësit janë të barabarta për të gjithë.

Po ashtu Lista Serbe ka propozua që nenin 11A, t'i shtohet një paragraf 4 me këtë përmbajtje: **4.„Së paku 2 anëtarë të komisionit për regjistrimin e bashkësive të reja fetare do të jenë përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës, ndërsa 1 anëtar do të jetë përfaqësues i komuniteteve të tjera jo shumicë.“** edhe për këtë amendament grupi punues ka konstatuar se është diskriminues dhe Grupi Punues ka propozuar amendamentin si vijon: „1 anëtar i Komisionit për regjistrimin e bashkësive të reja fetare do të jetë nga komuniteti serb i Kosovës, ndërsa 1 anëtar do të jetë nga komunitetet e tjera pakicë në Kosovë .“

Po ashtu tha se kemi edhe amendamentin e deputetit Nait Hasani, si vijon: „Të regjistrohet e të trajtohet në mënyrë të barabartë në projektligjin për liritë fetare dhe Kisha Ortodokse Shqiptare në Kosovë” edhe për këtë amendament si grup punues kemi qenë kundër, pasi që nuk kemi argumente të mjaftueshme, por nëse plotësohen kriteret e kërkuara me ligj, ka mundësi që të regjistrohet bashkësia fetare në procedurë të rregullt edhe pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Më pas, kryetarja tha se kemi 4 propozim amendamente nga deputeti, Imajl Kurteshi – nga GP Vetëvendosje, të cilat më shumë janë dhënë në mënyrë deklarative dhe nuk janë specifikuar, as në përmbajtje, e as në lidhje me cilat nene të Projektligjit kanë të bëjnë ato.

Grupi Punues i kemi shqyrtuar ato, por kemi konstatuar se disa propozime të lartpërmendura janë të rregulluara edhe me ligje të tjera, dhe të inkorporuar nëpër nene të ndryshme të Projektligjit dhe këto propozime janë dërguar në komision pa përkrahje të grupit punues.

Më tutje ajo sqaroi edhe dy propozime nga ana e Qeverisë, ku njëri ka qenë që në nenin 7 B, të fshihet paragrafi 2.2, ku thuhet - Me rastin e themelimit të një bashkësie fetare të kenë të paktën 50 (pesëdhjetë) anëtarë, shtetas të moshës madhore të Republikës së Kosovës;

Ne, si grup punues, nuk e kemi përkrahur këtë amendament dhe kemi propozuar që të shtohet numri i anëtareve në 100, dhe do të vendosim këtu në Komision se cili propozim të mbetet.

**Teuta Haxhiu** tha se propozimet e secilit grup apo të deputetëve i kemi shqyrtuar me kujdes të veçantë. Propozimet e listës serbe, 12 prej tyre i kemi pranuar apo i kemi përfshirë në propozimet tona si grup punues, por janë dy amendamente njëri prej tyre që ka të bëjë me pozitën e zëvendës drejtorit të zyrës, ku ne kishim prezent edhe përfaqësuesit e Qeverisë në takime dhe është sqaruar se këtë pozitë nuk e njeh ligji për shërbimin civil, andaj ne nuk mund të vendosim diçka jashtë ligjshëm në këtë projektligj.

Ndërsa amendamenti tjetër i listës serbe që kërkon dy anëtarë serbë në një komision ad-hok, i cili përbëhet prej 7 anëtareve, ky propozim është dukur i padrejtë, dhe për këtë meqë është ad-hok nga dëgjimi publik ka dalë që varësisht nga kërkesa e bashkësive fetare, përzgjidhet edhe përfaqësuesi i përzgjedhur i cili do të jetë nga bashkësia fetare, e cila ka parashtruar kërkesë”. D.m.th. nëse kërkesën e ka parashtruar komuniteti serb edhe deputeti shkon nga ky komunitet, në paragrafin 3 ne kemi marrë garancion që kjo rregullohet me akte nënligjore, por unë propozoj që në koordinim me paragrafin, 2.3 të rregullohet edhe 2.1.

Ndërsa sa u përket propozimeve të deputetit Ismajl Kurteshi, nga Lëvizja Vetëvendosje, nuk kanë qenë të specifikuara kanë qenë të përgjithësuara, ka qenë mirë të ishin përfaqësuesit e VV, në këtë mbledhje, por nuk janë.

**Luljeta Veselaj-Gutaj** tha se shqetësimet në grup punues ishin po këto që i potencuan parafolësit. Tha se amendamentet që kanë bërë propozuesit nuk kanë sjellë argumentet e duhura.

Lidhur me propozimet e z. Kurteshi, ajo theksoi se përfaqësuesit e këtij grupi parlamentar, kanë dhënë opinionet e tyre për projektligjin por, nuk ka pasur asnjë specifikim se çka konkretisht dhe në cilat nene duhet bërë ndryshim.

Më pas, foli për amendamentet e listës serbe, ku tha se kemi dhënë shumë sqarime, si nga ana e grupit punues, por dhe përfaqësuesit nga Qeveria kanë dhënë sqarime në detaje, për pozitën e zëvendës drejtorit nuk kemi të drejtë të krijojmë vende pune që nuk janë të parapara, ndërsa propozimi që në komision të jenë dy përfaqësues nga komuniteti serb, mendojë se është diskriminues sepse kemi komunitetet e tjera pakicë, si boshnjak turq, rom, ashkali etj. dhe në qoftë se në një komision me 7 anëtarë, fokusohemi që dy të jenë nga etniteti serb atëherë si do të përfaqësohen komunitetet e tjera?

Përpos kësaj, mendojë se brenda Komisionit ad-hok ka hapësirë që herë pas here, nga tre deputetët që përzgjidhen nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëri nga deputetët të jetë nga komuniteti serb.

**Mexhide Mjaku-Topalli** tha se në takimin e grupi punues ka propozuar edhe si komision duhet të përkrahim që në nenin 4 A, në paragrafin 4.5, në rreshtin e tretë pas „presjes” fshihet fjalia.

**Kryetarja** tha se si grup punues kemi vendosur që të pranohet edhe Bashkësia Bektashiane e Kosovës, ku grupi punues kemi bërë amendament për këtë çështje.

**Lirije Kajtazi** tha se propozimi i listës serbe për anëtarët në Komisionin ad-hoc është i papranueshëm sepse po ua merr të drejtën të tjerëve, ndërsa sa i përket pozitës së zëvendës drejtorit përfaqësuesit e Qeverisë kanë dhënë sqarimet e tyre lidhur me këtë çështje.

**Kryetarja** hodhi në votim amendamentin e Listës Serbe, për pozitën e zëvendës drejtorit të zyrës që të jetë nga komuniteti serb, dhe konstatoi se ky amendament nuk kalon.

**Kryetarja** po ashtu hodhi në votim amendamentin e listës serbe që „Së paku 2 anëtarë të komisionit për regjistrimin e bashkësive të reja fetare do të jenë përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, ndërsa 1 anëtarë do të jetë përfaqësues i komuniteteve të tjera jo shumicë”, kryetarja konstatoi se nuk kalon amendamenti i listës serbe por kalon amendamenti i grupit punues dhe deputetes Teuta por duhet me u rregulluar.

Ajo, po ashtu, tha se në nenin 7 B, kemi dy propozime, siç është propozimi i Qeverisë që të fshihet paragrafi 2.2. Me rastin e themelimit të kenë të paktën 50 (pesëdhjetë) anëtarë, shtetas të moshës madhore të Republikës së Kosovës, dhe ne, si grup punues, nuk e kemi përkrahur këtë amendament dhe kemi propozuar që të shtohet numri i anëtarëve në 100.

Ajo hodhi në votim dy amendamentet e lartpërmendura.

Kryetarja konstatoi se kalon propozimi i Grupit Punues, me të gjitha votat – për, dhe një abstenim, ndërsa komisioni nuk përkrah amendamentin e Qeverisë.

Ndërsa për amendamentin e deputetit, Nait Hasani, pas hedhjes në votim, kryetarja konstatoi se 4 vota janë për dhe dy abstenime.

Më pas, kryetarja hodhi në votim amendamentet e deputetit, Ismajl Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje.

Kryetarja konstatoi se Komisioni Funkcional nuk përkrah amendamentet e deputetit Ismajl Kurteshi, dhe se ato amendamente do të radhiten pa përkrahje të Komisionit Funkcional.

**Teuta Haxhiu** tha se aktet nënligjore hiqen nëpër nenet e caktuar dhe mbeten vetëm te neni 13B, i projektligjit, por duhet riformuluar neni dhe të përfshihen të gjitha aktet që duhet nxjerrë që i parasheh projektligji.

**Kryetarja** tha se për këtë jemi pajtuar edhe në grupin punues dhe kjo çështje do të rregullohet me administratën e komisionit.

Ajo pastaj hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë bashkë me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte: 7 vota për, 0 vota kundër dh 0 vota abstenim.

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi Projektligjin me amendamentet e miratuara dhe procedimi vazhdon në komisionet e përhershme të Kuvendit.

### 3. Të ndryshme

**Lirije Kajtazi** tha se ligji për barazi gjinore parasheh masa afirmative për avancim të çështjeve gjinore dhe ka qenë në fuqi udhëzuesi për regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe se këtij udhëzuesi kalon afati në prill. Do të ishte mirë me i propozuar Qeverisë që të

vazhdojë vlefshmërinë e këtij udhëzuesi edhe për një vit, pasi që ka treguar rezultate në këtë drejtim.

**Kryetarja** tha se pajtohem me këtë propozim të nënkryetares, Lirije Kajtazi.

Më pas, kryetarja propozoi që më 27 mars 2018, në orën 09:00, të vizitohet AUV, lidhur me ngjarjet e fundit me importin e mishit në Kosovë.

**Mexhide Mjaku-Topalli** tha se ka propozuar që në komision të ftohet ABGJ, përfaqësuesi i MPMS-së dhe Koordinatori Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2016-2020, dhe plani i veprimit, dhe po ashtu të bëhen vizitat që janë paraparë nëpër njësitet për të drejtat e Njeriut dhe qendrat për ndihme juridike falas nëpër komuna, dhe të fillohet me monitorimin e ligjeve ashtu siç janë formuar grupet punuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje